



Intervistë me: **DONIKA NURA** nga: **EDONA MËZIU**

"Një gjë që na shoqëron gjatë punës sonë janë emocionet sepse të gjitha palët vijnë në zyrë me një problem të caktuar. Ndodh që ato të ndikojnë edhe tek unë..."

Unë e konsideroj veten me fat që kam punuar me znj. Donika Nura në një nga zyrat mobile të Agjencisë së Ndhmës Ligjore Falas (ANJF) në Skenderaj. Që kur fillova të punoj si praktikante në këtë Agjenci në kuadër të aktivitetit Drejtësia Vlen vitin e kaluar, jam informuar më mirë për punën e vlefshme të bërë nga zyrtarët e Agjencisë dhe rolin e saj të rëndësishëm në sigurimin e qasjes në drejtësi për të gjithë qytetarët.



Donika Nura - Zyrtare Ligjore

Gjithashtu, kjo periudhë më ka ndihmuar shumë për të zgjeruar njohuritë e mia profesionale në aspektin praktik dhe për të zhvilluar aftësitë e komunikimit. E gjithë kjo përvojë ka qenë shumë e dobishme për të më ndihmuar të fitoj etikë pune ndërsa punoja në një mjedis dinamik të punës. Shpresoj që të tjerët të kenë mundësinë të punojnë me njerëz të tillë frymëzues, të cilët ju inkurajojnë të rriteni profesionalisht dhe të jepni kontributin maksimal për komunitetin tuaj. Më poshtë, përmes një interviste të shkurtër me zyrtaren Donika Nura, do të mësoni më shumë për përvojën dhe ndikimin e saj.

1. Pse vendosët të studioni në Fakultetin Juridik?

Nuk mund të them se gjithmonë kam dashur të bëhem juriste, sepse kisha profesione të tjera në mendje. Megjithatë, në fund të shkollës fillore, pasi që fillova të lexoja më shumë për drejtësinë vendosa të studioj juridikun.

2. Sa ju ka ndihmuar puna si zyrtar në ANJF të bëheni më komunikativ me njerëzit?

Që kur punoj si zyrtare për ndihmës juridike falas, pata mundësinë të punoj drejtpërdrejt me palë. Kjo më ka ndihmuar shumë që të bëhem më komunikuese me njerëzit dhe të kuptoj më mirë nevojat e qytetarëve për drejtësi.

3. Cilat janë sfidat që shoqërojnë punën tuaj si zyrtar në zyrën mobile në Skenderaj?

Si çdo punë, puna si zyrtare e ANJF-së ka sfidat e veta. Një nga sfidat me të cilat përballemi si zyrë është pasiguria në lidhje me qëndrueshmërinë e zyrës sonë, meqë zyra jonë është hapur me mbështetjen e donatorëve. Kjo po ka ndikim negativ në mua ashtu edhe te palët.

4. Në cilën çështje ligjore ofrohet më shumë ndihma juridike falas?

Ndihma juridike falas ofrohet në katër fusha ligjore: administrative, civile, penale dhe kundërvajtje. Shumica e çështjeve tona janë nga fusha administrative, e cila ka të bëjë kryesisht me ndihmën sociale dhe pensionin.



Donika dhe Edona në zyrën mobile në Skenderaj

5. Si është të punosh me një praktikant në zyrë?

Unë mendoj se është një mundësi e shkëlqyer që aktiviteti i USAID-it Drejtësia Vlen u ofron studentëve mundësinë për t'u përfshirë dhe për të hedhur hapin e parë drejt përparimit profesional. Mendoj se është një mundësi shumë e dobishme pasi jep një kuptim më të mirë të profesionit, nevojave ligjore të qytetarëve dhe kontributin që mund të jepni.

6. Njerëzit me probleme të ndryshme vijnë për të kërkuar ndihmë juridike falas. Sa ndikon kjo në gjendjen tuaj emocionale në baza ditore?

Një gjë që na shoqëron gjatë punës sonë janë emocionet sepse të gjitha palët vijnë në zyrë me një problem të caktuar. Ndodh që ato të ndikojnë edhe te unë, por përpiqem që të mos i ndërlihdh emocionet me punën. Sidoqoftë, në shumë raste kjo është e pashmangshme. Përveç komunikimit të shkëlqyeshëm me kolegët tuaj nga zyra të tjera dhe mundësisë për të shkëmbyer përvojat, ju gjithashtu keni ndjekur trajnime të ndryshme.

7. Sa ju kanë ndihmuar trajnimet për të përmirësuar punën tuaj dhe për të zgjeruar njohuritë profesionale?

Po, unë kam një komunikim të shkëlqyeshëm me të gjithë kolegët nga zyrat e tjera, gjë që na ndihmon të konsultohemi me njëri-tjetrin për çështje të ndryshme që lidhen me punën. Jam gjithashtu shumë mirënjohës për trajnimet e organizuara nga ANJF, me mbështetjen e donatorëve të ndryshëm, sepse ne përfitojmë shumë nga njohuritë dhe përvojat e njerëzve që na trajnojnë, siç janë gjyqtarët, avokatët, prokurorët.

8. A preferoni të punoni nga shtëpia apo të punoni në zyrë?

Padyshim, puna në zyrë. Duke marrë parasysh natyrën e punës tonë, ajo është më efektive kur punojmë nga zyra. Mendoj se është e njëjta gjë edhe për palët tona.

9. Sa e vështirë ka qenë të komunikoni me palët dhe të punoni gjatë pandemisë COVID-19?

Meqenëse puna jonë lidhet drejtpërdrejt me kontaktin me palë dhe duke pasur parasysh kategorinë e njerëzve që janë përfitues të ndihmës juridike falas, të cilët në shumicën e rasteve nuk kanë qasje në internet, puna online ka qenë shumë sfiduese gjatë pandemisë. Sidoqoftë, ne kemi ofruar shërbime ligjore katërore postës elektronike dhe përmes telefonit.

10. "Cila është zyra e avokatit?" është një pyetje që shpesh dëgjohet në korridorin e QPS-së (Qendra për Punë Sociale). A është avokatia pjesë e planeve tuaja për të ardhmen?

Në fakt, të punosh si zyrtar i ndihmës juridike është e ngjashme me atë të avokatit. Qëllimi im është të bëhem pjesë e gjyqësorit në të ardhmen.

11. A ka diçka që nuk ju pëlqen në punën që bëni?

Jo, nuk ka asgjë që nuk më pëlqen në punën që bëj. Ndër të tjera, puna si zyrtar i ndihmës juridike jep vlerat kënaqësi shpirtërore, veçanërisht duke pasur parasysh kategoritë e njerëzve që je në gjendje të ndihmosh.

12. Sipas mendimit tuaj, çfarë duhet të bëhet për t'i bërë qytetarët më të vetëdijshëm për ekzistencën e Agjencisë?

Në mënyrë që qytetarët të informohen më shumë për ndihmën juridike falas, duhet të bëhen fushata të ndryshme vetëdijësuese, veçanërisht në qytetet ku ka zyra për ndihmë juridike falas. Kjo mund të bëhet përmes reklamave të ndryshme televizive, takimeve me akterë institucionalë dhe kontakteve të drejtpërdrejta me klientët e mundshëm të ndihmës juridike.

Në lidhje me këtë intervistë: Kjo intervistë u zhvillua nga praktikantët të aktivitetit Drejtësia Vlen si pjesë e projektit "te dëgjimit". Intervistë me profesionistë ligjor. Aktiviteti Drejtësia Vlen është një projekt tre vjeçar për të përmirësuar qasjen në drejtësi për të gjithë, përfshirë grupet e disfavourizuara dhe të marginalizuara, duke forcuar institucionet, akterët dhe proceset për ofrimin e shërbimeve dhe informacionit ligjor.